



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KESHILLI I BASHKISË SE QYTETIT KORÇE

VENDIM
NR. 62 Date 23.6. 2008

**Per caktimin e garancise financiare per mbetjet e parashikuara nga
ndertimi ose prishja**

Keshilli I Bashkise ne mbledhjen e tij te dates se sotme pasi morri ne shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria Juridike, Drejtoria e Kontrollit dhe Zhvillimit Urban, Drejtoria e Menaxhimit te Kontratave te Infrastruktures dhe Drejtoria e te Ardhurave dhe mbeshtetur nenin 32 te ligjit 8652, daten 31.07.2000 "Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", ne Regulloren Nr.1, Date 30.03.2007, "Per trajtimin e mbetjeve te ndertimit nga krijimi, transportimi e deri asgjesimi i tyre" Neni 10, ne piken 2 te nenit 12 te ligjit Nr.9010, date 13.02.2003 "Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta" si dhe ne".

VENDOSI:

- I. Te miratoje ngurtesimin e vleres prej 5 % nga kerkuesi i lejes, perpara leshimit te lejes se ndertimit ose te shembjes per nje strukture qe prodhon mbetje ndertimi.
- II. Kjo % do te llogaritet ne baze te preventivit paraprak te dorezuar per leje ndertimi per zerat germim dheu dhe /ose ne baze te preventivit per ndertimi
- III. Vlera e depozituar prane pushtetit vendor do t'i kthehet depozituesit pa interes, pas perfundimit te stuktures qe prodhon mbetje ndertimi si dhe pajisjes se tij me vertetim nga Drejtoria Menaxhimit te Kontratave te Infrastruktures e te Ardhurave per depozitim e ketyre mbetjeve sipas rregullit ne impianti I venddepozitimit te mbetjeve.
- IV. Depozita konfiskohet ne rast se nuk permbushen kerkesat e mesiperme.
- V. Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Drejtoria, Drejtoria e Kontrollit dhe Zhvillimit Urban, Drejtoria e Menaxhimit te Kontratave te Infrastruktures e te Ardhurave dhe Drejtoria e Finances.
- VI. Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

Rajmonda NASE

Rajmonda NASE
KRYETARE